



Udhëzues për plotësimin e LIBRIT TË SHITJES

Data: Shëno datën e faturës. Formati duhet të jetë: data / muaji / viti, p.sh. 01.02.2024. Kjo rubrikë është mandatore.

Numri i faturës: Shëno numrin e faturës së shitjes. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

Emri i blerësit: Shëno emrin e plotë të blerësit të cilit i janë furnizuar mallra / shërbime, p.sh.. "XXXXX" SH.P.K. Formati është i lirë, rubrika është mandatore.

Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit / Numri Fiskal: Shëno Numrin Unik të Regjistrimit të Biznesit – blerësit apo Numrin Fiskal të blerësit. Numri Unik i Regjistrimit të Biznesit – formati është 9 shifror (personat që janë të regjistruar në ARBK), fillon me 81... dhe përmban vetëm numra. Numri Fiskal - formati është 9 shifror, fillon me 6... dhe përmban vetëm numra (personat që janë të regjistruar në ATK); Në rastet kur shitjet janë nga Pajisja Elektronike Fiskale/Sistemi Fiskal, Eksportet, duhet të vendosen numrat sipas tabelës së mëposhtme. Kjo rubrikë është e validueshme dhe është rubrikë mandatore.

Në vijim gjeni sqarimet se si duhet të plotësohet kolona e NUI / NF:

LIBRI I SHITJES	
Vendosja e Numrit në Kolonën e NUI/NF	Përshkrimi
81XXXXXX	NUI me 81... vendoset për Shitjet për personat e regjistruar në ARBK.
60XXXXXX	NF me 6... Vendoset për Shitjet për personat që janë të regjistruar në ATK.
1	Numri 1 vendoset për Shitjet nga Pajisja Elektronike Fiskale / Sistemi Fiskal, gjegjësisht Pazari ditor.
2	Numri 2 vendoset për Shitjet e shërbimeve jashtë vendit, pra nëse plotësohet rubrika b.
3	Numri 3 vendoset për Eksportet, pra nëse plotësohet rubrika c.
0	Zero vendoset në rastet kur Libri i Shitjes deklarohet pa transaksione, pra deklarimi i librit me zero.

[a] Shitjet e mallrave/shërbimeve brenda vendit: Vendos të gjitha shitjet e mallrave dhe shërbimeve të bëra brenda vendit. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[b] Shitja e shërbimeve jashtë vendit: Vendos të gjitha shitjet e shërbimeve jashtë vendit. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[c] Eksportet: Vendos të gjitha shitjet e mallrave jashtë vendit. Formati është numër, nuk është rubrikë mandatore.

[d] Shitjet totale: Vendos të gjitha shitjet duke mbledhur rubrikat a + b + c. Formati është numër, është rubrikë kalkuluese, e cila mbledh rubrikat (d = a + b + c).

Vëmendje: Libri i Shitjes duhet të deklarohet edhe nëse nuk ka transaksione brenda periudhës tatimore. Pra, deklarimi bëhet me zero (0).